



VENDIM

Nr. 232, datë 03.11.2016

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN "PËR PROCEDURAT DHE KRITERET PËR DHËNIEN E LICENCËS SË TRANSMETIMIT AUDIO", MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 153, DATË 18.07.2016 TË AMA-S

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1/ë dhe 16, të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Autoriteti i Mediave Audiovizive,

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimeve në Rregulloren "Për procedurat dhe kriteret për dhënie e licencës së transmetimit audio", miratuar me vendimin nr. 153, datë 18.07.2016 të AMA-s, si më poshtë vijon:

1.1 Paragrafi (iii) i gjurmës b të nenit 16 të Rregullores riformulohet si më poshtë:

"(iii) Tipi dhe karakteristikat teknike të pajisjeve transmetuese, hartuar nga një inxhinier elektronik i pajisur me diplomën përkatëse (Master Shkencor);"

1.2 Paragrafi (ii) i pikës 1.2 të nenit 19 të Rregullores riformulohet si më poshtë:

"ii. Projektin dhe preventivin e rrjetit [(a) skema e organizimit, (b) projektet teknike të studiove; (c) projektet teknike të pikave të transmetimit; (d) karakteristikat teknike të pajisjeve transmetuese] hartuar nga një inxhinier elektronik i pajisur me diplomën përkatëse (Master Shkencor);"

1.3 Paragrafët 2.1, 2.3 të pikës 3 të nenit 39 të Rregullores riformulohen si më poshtë:

*"2.1 Projektin teknik të instalimit dhe shfrytëzimit të aparaturave dhe preventivi përkatës hartuar nga një inxhinier elektronik i pajisur me diplomën përkatëse (Master Shkencor).
5 pikë"*

*2.3 Projektin dhe preventivin e rrjetit, të shërbimeve fikse, frekuencat e të cilave administrohen nga AKEP, hartuar nga një inxhinier elektronik i pajisur me diplomën përkatëse (Master Shkencor).
5 pikë"*







1.4 Neni 46 i Rregullores riformulohet si më poshtë:

"1. Aplikimet për rinovimin e licencës së transmetimeve audio, të bëra para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, por që, për të cilat ende nuk është marrë një vendim, do të shqyrtohen në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore që kanë qenë në fuqi në datën e paraqitjes së aplikimeve.

2. Pavarësisht përcaktimit të pikës 1 këtij neni, licenca e këtyre subjekteve radiofonike privatë vendorë do të rinovohet për një afat 5 vjeçar".

2. Ngarkohet administrata e AMA-s për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:	Gentian	SALA	
Zëvendëskryetar:	Sami	NEZAJ	
Anëtarë:	Agron	GJEKMARKAJ	
	Gledis	GJIPALI	
	Piro	MISHA	
	Suela	MUSTA	
	Zylyftar	BREGU	